

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr.04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21 dhe 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-03 dt.21.06.2016, nenit 17, pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, dhe në bazë të kërkesës 05 Nr.350/02-131507/21 dt.07.07.2021, të pronarëve: **Bashkim, Sabri dhe Bekim Rama, me investitor: "Bautrade" Sh.p.k., Ratkoc, Rahovec**, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor, për ndërtimin e kompleksit të shtëpive individualë të banimit në Bërnice të Epërme, Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 16.03.2022, merr këtë:

V E N D I M PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

I. I Caktohen kushtet ndërtimore pronarve: Bashkim, Sabri dhe Bekim Rama, me investitor: "Bautrade" Sh.p.k., Ratkoc, Rahovec, sipas kërkesës 05 Nr.350/02-131507/21 dt.07.07.2021, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor për lejimin e ndërtimit të kompleksit të shtëpive individualë të banimit, në kuadër të Planit Zhvillimor Urban në Prishtinë, në kuadër të parcelave kadastrale nr.962-4, 964-0, 963-0, ZK.Bërnice të Epërme.

II. Lokacioni i parcelës kadastrale të lartcekur, për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, sipas dokumenteve të planifikimit hapësinor, përfshihet në kuadër të: Planit Zhvillimor Urban, miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01.nr.035-181427 të dt. 24.09.2013. Bazuar në këtë planë kjo zonë është e paraparë për ndërtim individual, dhe për këtë pala është njoftuar përmes shkresës zyrtare me nr.04-350/01-27568/21 dt.15.02.2021, lëshuar nga Drejtoria e Planifikimit Startegjik dhe Zhvillim të Qëndrueshëm.

III. Gjendja ekzistuese e lokacionit - parcelës kadastrale të trajtuar, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

- Numri, sipërfaqja, pronari dhe klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, është:
 - Parcela kadastrale nr.962-4, ZK.Bërnice të Epërme, me S=1,206m², me pronar: **Bashkim, Sabri dhe Bekim Rama**, sipas çertifikatës së njësisë kadastrale kualiteti i tokës është: tokë bujqësore, Arë e klasës 7;
 - Parcela kadastrale nr.964-0, ZK.Bërnice të Epërme, me S=6,273m², me pronar: **Bashkim, Sabri dhe Bekim Rama**, sipas çertifikatës së njësisë kadastrale kualiteti i tokës është: tokë bujqësore, Arë e klasës 7;
 - Parcela kadastrale nr.963-0, ZK.Bërnice të Epërme, me S=1,293m², me pronar: **Bashkim, Sabri dhe Bekim Rama**, sipas çertifikatës së njësisë kadastrale kualiteti i tokës është: tokë bujqësore, Arë e klasës 7;
- E drejta pronësore-juridike është private, në bazë të kopjes së planit dhe çertifikatës së njësisë kadastrale;
- Në kuadër të parcelave kadastrale të lartcekur nuk ka ndërtesa ekzistuese;
- Është tokë urbane, me infrastrukturë: rrugë, ujë, kanalizim, elektrikë, etj.;
- Terreni është mesatarisht i pjerrët;
- Qasja ekzistuese e parcelave kadastrale është përmes rrugës publike ekzistuese;

- Në kuadër të perimetrit prej 50m' të parcelës kadastrale në fjalë, përfshihen ndërtesa individuale banimore dhe afariste.

IV. Kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit ideor, për rregullimin e hapësirës dhe realizimin - ndërtimin e shtëpisë së banimit, në kuadër të PZHU-së në Prishtinë, bazuar në parametrat urban të planit, janë:

- Organizimi me qasje në kuadër të parcelave kadastrale, pozicionimi, gabariti dhe etazhiteti i ndërtesës, në raport me vijën rregulluese dhe atë ndërtimore, distanca e ndërtesës nga kufiri i parcelave, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në Planin e lokacionit – “zgjidhja urbane”, bashkëngjitur këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore;
- Zgjidhja Urbane e Planifikuar, përmban gjithsejtë 20 parcela ndërtimore të krijuara dhe 20 shtëpi individuale të banimit në varg, nga këto 6 shtëpi me etazhitet P+1, 10 shtëpi me etazhitet B+P+1 dhe 4 shtëpi me etazhitet P+1+Nk. Sipërfaqja e parcelave kadastrale e planifikuar për shtëpitë e banimit në varg është: 201m², 203m², 204m², 212m², 214m², 218m², 225m², 241m², 248m², 266m² dhe 371m². Në kuadër të zgjidhjes urbane është planifikuar një hapësirë gjelbëruese, rekreative me S=81m² dhe rruga me sipërfaqe totale S=1053m², me gjerësi 5.5m gjerësi dhe trotuar 1.5 m;
- Për realizimin e kompleksit të shtëpive individuale të banimit, janë trajtuar parcelat kadastrale nr.962-4, 964-0, 963-0, ZK.Bërnice e Epërme.
- Sipërfaqja e parcelave kadastrale nr.964-0, 962-4 dhe 963-0, ZK.Bërnice e Epërme të trajtuara për realizimin e kompleksit të shtëpive të banimit në varg **brenda vijës rregulluese të planifikuar është, është: S=4,756m²;**
- Sipërfaqja e parcelave kadastrale nr.964-0, 962-4 dhe 963-0, ZK.Bërnice e Epërme, të trajtuara për realizimin e infrastrukturës rrugore dhe gjelbërimit është **S=1,134m²;**
- Sipërfaqja e parcelave kadastrale nr.964-0 dhe 963-0, ZK.Bërnice e Epërme e cila përfshihet në zonën mbrojtëse të unazës është S=2,882m²;
- Destinimi i shfrytëzimit bazuar në kërkesën e palës si dhe destinimin e ndërtesave në diametër prej 50m', të jetë banim (sipas projektit konceptual të prezantuar);
- Etazhiteti maksimal i lejuar, sipas PZHU-së, për shtëpi banimi është P+2, kjo mund të arrihet duke i respektuar kriteret e poshtëshënuara në këtë Vendim, sipas propozimit është B+P+1 dhe P+1+Nk;
- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelës ndërtimore- brenda vijës rregulluese (ISHP), për vendosjen e ndërtesës në bazë-gabarit të përdhësës ose suteren, sipas PZHU-së, është 20%-30%;
- Indeksi i sipërfaqes së përgjithshme të ndërtimit 0.6-0.8 e sipërfaqes së parcelës;
- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal i parcelës ndërtimore për sipërfaqet gjelbëruese (ISHGJ), bazuar në paragrafin II. pika 2. të Vendimit 01nr.031-185481 dt.14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, është min.40%;
- Bazuar në kriteret e PZHU-së, distancat në mes ndërtesave është 1 deri 1.5h, ndërsa nga kufiri i parcelës 0.50-0.75H.
- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt.14.08.2016 dhe protokolluar me numrin 01 nr. 031-185481, për shkaqe të shfrytëzimit eficient të energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore, ndërsa duhet të kalkulohet në përcaktimin e distancave të ndërtesës nga kufiri i parcelës fqinje;
- Ngritja e nivelit të përdhësës nga rruga / niveli i terrenit, të jetë max.0.45 m';
- Distanca në mes vijës rregulluese dhe vijës ndërtimore të jetë 5.5m' te rruga e planifikuar për qasje në ndërtesë;
- Qasja në parcelë të jetë nga rruga e planifikuar, të paraqitur në Planin e situacionit - “zgjidhja urbane” të parcelës;
- Në kuadër të parcelës të parashihet hapësira për vendosjen e mbeturinave;
- Arkitektura/dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të eficientës së energjisë, dhe ti përshtatet destinimit të ndërtesave të planifikuara;

- Zgjidhja e kulmit duhet të projektohet dhe të ekzekutohet ashtu që të jetë në harmoni me projektin arkitektonik dhe uji i strehëve duhet të derdhet brenda parcelës ndërtimore.

V. Bashkimi i parcelave kadastrale nr.962-4, 964-0, 963-0, ZK.Bërnice e Epërme, sipas parcelës ndërtimore bazuar në Plani i situacionit – “zgjidhja urbane” dhe manualin e bashkimit të parcelave, punuar nga gjeometri i licencuar, do të bëhet në një parcelë të vetme - parcelë ndërtimore të cilat më pastaj do të riparcelohen sipas përshkrimit në pikën VI, të këtij Vendimi, bazuar në Plani i situacionit – “zgjidhja urbane” dhe manualin e bashkimit të parcelave, punuar nga gjeometri i licencuar.

Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për bashkimin e pjesëve të parcelave të lartcekura sipas, Planit të situacionit-“zgjidhja urbane” dhe manualit të bashkimit të parcelave, e i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Procedura e bashkimit të do të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronarëve dhe investitorit, duke u bazuar në Plani i situacionit-“zgjidhja urbane” dhe manualin e bashkimit të parcelave, punuar nga gjeometri i licencuar, i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore

VI. Ndarja / parcelimi, i parcelave kadastrale nr.962-4, 964-0, 963-0, ZK.Bërnice e Epërme, do të realizohet sipas parcelave ndërtimore, të përcaktuara me vijën rregullimit-bazuar në Planin e situacionit – “zgjidhja urbane” dhe manualin e ndarjes, punuar nga gjeometri i licencuar.

Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për ndarjen e parcelave kadastrale të lartcekura, sipas Planit të situacionit - “zgjidhja urbane” dhe manualit të ndarjes. Procedura e ndarjes/parcelimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e përshkruar në këtë paragraf, e i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Procedura e ndarjes së parcelave të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronarëve dhe investitorit, duke u bazuar edhe në Plani i situacionit - “zgjidhja urbane” dhe manualin e ndarjes së parcelave, punuar nga gjeometri i licencuar, i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

VII. Kyçja në infrastrukturë - marrja e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR “Prishtina”, bëhet me aplikim nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin-adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të ndërtesës(destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për elektrike dhe ujë).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga “Termokos”-Ngrohitorja e Qytetit sh.a. dhe PTK.

VIII. Dokumentacioni ndërtimor - projekti ideor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, të dorëzohet në tre (3) kopje të shtypura, dhe një (1) digjitale dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Planin e situacionit të gjerë, në diametër prej 50m`, me ndërtesat ekzistuese dhe të planifikuara, në përpjesë 1:500 apo 1:1000, punuar në bazë të incizimit gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesës së projektuar dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Planin e situacionit të parcelës, në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë dhe me pozicionim të ndërtesës në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të platove, trotuareve, rrugëve dhe hyrjeve në përdhësë, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;

- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:100, për ndërtesën e projektuar, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhësë dhe etazheve tjera, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Dukja e jashtme e ndërtimit, tridimensionale - perspektivë;
- Planin me vendin e qasjes në ujësjellës dhe kanalizim, në përpjesë 1:100;
- Planin me vendin e qasjes në furnizim me energji elektrike në përpjesë 1:100;
- Përshkrimin teknik të punëve ndërtimore;
- Paramasën dhe parallogarinë e punëve ndërtimore dhe ndërtimore zejtare;
- Detajet karakteristike dhe të nevojshme, në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20;
- Situacionin me përshkrimin teknik të "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim";
- Masat propozuese për fizikën ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma, me analiza dhe masa konkrete;
- Deklaratën e projektuesit për fazat e nevojshme

IX. Marrëveshja për infrastrukturë – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të “Rregullore mbi Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01 nr. 434/01–0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave e Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin/investitorin. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushtet ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të kompanisë investuese;
- Kontratën për bashkëinvestim (nëse është prezantuar në kërkesën për leje ndërtimore);
- Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);
- Kopjen e letërnjoftimit të kërkuesit/ve (bashkëpronarëve të parcelës-ave dhe investitorit);

X. Paguesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore - meqenëse parcelat kadastrale nr.962-4, 964-0, 963-0, ZK.Bërnice e Epërme, në bazë të certifikatës së njësisë kadastrale, janë evidentuar me lloj të shfrytëzimit të parcelës-tokë bujqësore, me klasë të kualitetit “Arë e klasës 7”, kërkohet që paraprakisht të bëhet pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, konform nenit 11, 13 dhe 14 të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe nenit 8, 9 dhe 14 të Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që e rregullojnë këtë fushë. Sipërfaqja e tokës bujqësore, të cilës do ti ndërrohet destinimi, do të përcaktohet pas ndarjes së pjesëve të parcelave të cilat kalojnë në infrastrukturë rrugore, krijimit të riparimit sipas Zgjidhjes Urbane dhe bashkimit të parcelave kadastrale sipas Planit i situacionit – “zgjidhja urbane”, dhe parcelës ndërtimore të caktuar me Planin Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim”. Parcelat e krijuara do të regjistrohen si tokë ndërtimore, në regjistrin kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, Ky kompensim - pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, në fazën e zhvillimit të procedurës administrative për marrjen e lejes ndërtimore.

XI. Paguesa e taksës administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të realizohet sipas “Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01Nr.434/01 – 0094474/17 dt.24.04.2017 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor / projektin kryesor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Paguesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

XII. Para aplikimit për leje ndërtimore duhet të bëhet ndërimi i destinimit të parcelave të planifikuara për rrugë dhe gjelbërim, sipas zgjidhjes urbane të planifikuar. Ndërimi i destinimit të kësaj parcele duhet të bëhet pas përfundimit të procedurës së bashkimit dhe ndarjes së parcelave kadastrale nr.962-4, 964-0, 963-0, ZK.Bërnice e Epërme.

XIII. Vlefshmëria e vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore do të jetë një (1) vit, me mundësi të vazhdimit për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

A r s y e t i m

Pronari **Bashkim, Sabri dhe Bekim Rama, me investitor: Bautrade"Sh.p.k., Ratkoc, Rahovec,** me kërkesën **05 Nr.350/02-131507/21 dt.07.07.2021,** ka kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor, për ndërtimin e kompleksit të shtëpive të banimit në varg, në lokacionin e përshkruar në paragrafin I. të dispozitivit të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

Me kërkesë, pronari ka prezantuar dokumentacionin, si në vijim: kopjet e planit dhe certifikatat e njësisë kadastrale, për parcelat kadastrale nr.962-4, 964-0, 963-0, ZK.Bërnice e Epërme. Vërtetimin e tatimit në pronë me nr.47148/21 dt.12.03.2021 në emër të Bashkim Rama, Bekim Rama, Sabri Rama, Informimin nga plani me 04-350/01-27568/21 dt.15.02.2021, lëshuar nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillim të Qëndrueshëm, Kontratën mbi ndërtimin e përbashkët me LRP.Nr.6633/2021 dt.14.05.2021, Inçizimin gjeodezik dhe manualin për ndarje dhe bashkim, të punuar nga Atdhe S.Buzhala, me nr. të lic.178.Kopjet e letërnjoftimit të bashkëpronarëve;

Drejtorja e Urbanizmit bazuar në nenin 13, pika 1.2 të UA të MMPH-së Nr. 06/2017 dt.13.09.2021, ka vendosur njoftimin me datë 27.09.2021. Ky njoftim publik, sipas rregullativës ligjore, ka qëndruar pesë (5) ditë në lokacionin në fjalë dhe meqë ndërkohë kjo drejtori nuk ka pranuar ndonjë vërejtje apo sugjerim, është vazhduar me procedurën për caktimin e kushteve ndërtimore.

Drejtorja e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës, konsultimit të dokumenteve të planifikimit për hapësirën ku gjendet lokacioni (PZHU-së), rregullativës ligjore në fuqi nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe i procedurës së përgjithshme administrative, konkretisht nenin 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L- 110 dt. 31.05.2012, nenin 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 31.07.2013, nenin 7 dhe 8 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimin për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", projektit konceptual, Drejtoria e Urbanizmit ka konstatuar se kërkuuesit kanë prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, dhe se projekti konceptual i prezantuar, është në harmoni me destinimin dhe kriteret tjera të PZHU-së për atë hapësirë, si dhe në harmoni me rrethinën, andaj konstatohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për caktimin e këtyre kushteve ndërtimore.

Nga sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.


Shtojcë: Plani i situacionit -"zgjidhja urbane".

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund të drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror-MMPHI-ja.


Ky vendim u printua në 5 (pesë) kopje identike dhe i dërgohet: Kërkuuesit, Qendrës për shërbim me qytetarë, kësaj drejtorie dhe në dosje të lëndës **05 Nr.350/02-131507/21 dt.07.07.2021.**

Kopja elektronike i dërgohet: Drejtorisë së Kadastrit dhe Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 Nr.350/02-131507/21 DT. 16.03.2022**

Zyrtari,
Anita Osmani


u.d. Udhëheqëse e Sektorit
Mimoza Berisha Prestreshi



Faqe 5 prej 5





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja / Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOV. / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale /
Opštinska katastarska kancelarija: Prishtinë

Zona kadastrale / Katastarska zona: Bëmicë e Eperme


Lloji i njësish kadastrale / Vrsta katastarske jedinice : Shtëpi

Nr. i njësish kadastrale /
Br. katastarske jedinice : _____

Numri i lëndës / Broj predmeta: _____

Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1: 750

Nr	Y	X	21	22	42	63
1	7513505.689	4729803.981	7513608.612	4729778.328	7513522.744	4729778.620
2	7513523.702	4729801.221	7513600.613	4729777.896	7513523.702	4729782.894
3	7513531.606	4729800.010	7513592.611	4729777.464	7513528.615	4729772.566
4	7513532.839	4729799.821	7513584.609	4729777.033	7513532.792	4729774.822
5	7513544.329	4729800.079	7513577.752	4729776.663	7513544.461	4729773.178
6	7513554.360	4729800.303	7513576.608	4729776.666	7513559.346	4729771.081
7	7513561.789	4729800.470	7513575.816	4729776.746	7513574.233	4729768.983
8	7513564.376	4729800.683	7513566.429	4729778.069	7513575.446	4729768.812
9	7513574.353	4729801.503	7513562.248	4729779.503	7513577.382	4729768.729
10	7513582.337	4729802.160	7513546.067	4729780.938	7513589.582	4729769.387
11	7513589.269	4729802.730	7513535.509	4729782.426	7513601.014	4729770.004
12	7513590.322	4729802.780	7513531.549	4729786.452	7513611.304	4729770.559
13	7513598.329	4729803.164	7513523.702	4729787.077	7513624.449	4729771.268
14	7513606.335	4729803.548	7513504.149	4729790.012	7513622.409	4729743.593
15	7513614.341	4729803.931	7513503.738	4729786.282	7513616.972	4729744.833
16	7513622.381	4729804.316	7513501.304	4729779.305	7513606.893	4729747.131
17	7513628.279	4729804.599	7513497.090	4729767.200	7513602.290	4729748.180
18	7513625.184	4729779.222	7513501.180	4729766.700	7513597.114	4729749.292
19	7513624.617	4729779.191	7513513.970	4729764.760	7513588.649	4729751.110
20	7513616.614	4729778.759	7513516.041	4729764.427	7513586.244	4729751.597
			7513521.626	4729776.254	7513571.521	4729754.576



Rilevoi / Snimio: Atdhe S.Buzhala

Nr. i licencës / Br. licence: 178

Nënshkrimi / Potpis: [Signature]

Data e rilevimit / Datum snimanja: 13.11.2021



Aprovi / Usvojio: _____


Nënshkrimi / Potpis: _____

Data e aprovimit / Datum usvajanja: _____



962-2

965



PRISHTINA

Komuna e Prishtines

Orientimi



Lokacioni
Berrnice e Eperme
Prishtine

Situacioni
P=1:500

Investitori :
BAUTRADE SH.P.K.

Projektues :
BAUTRADE SH.P.K.